

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Fluks i lartë dhe trafik i rënduar, shqiptarët krijojnë vetë korsinë e tretë në autostradë
ADRESA	https://joq-albania.com/artikull/1391544.html
BURIMI	joq-albania.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	14 shtator 2026, 12:11:43 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
LEXUAR NGA FAQJA	14 shtator 2026, 11:58:00 UTC <i>Portali nuk e deklaroi datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me meto dën text_date. Dritarja: 14 shtator 2026, 11:57:00 UTC → 14 shtator 2026, 11:59:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund t ë gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	ed63e9cfccafc5e94e4e9e0896b2a15f8c67727cf0d999dc95a4899a90ea2700
TEKSTI	efa9e2bf0986438f5b5dcb84862698280c196d0d12fab5b9fdda21501e52d0b9
PAMJA	67b0f03c611eeb13b4065393964666ebfe1fafdde65b04ff376866f18f471609

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	e2e417dc0792edc34042ef8163c7623336eb49275f2fdee58d4ffec7b3ae27f5
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	47dca60bb12c3dc439ebb43dab156a56f0c4323b738cbf9a7b5f92b8b605451e
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/e2e417dc0792edc34042ef8163c7623336eb49275f2fdee58d4ffec7b3ae27f5>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Fluks i lartë dhe trafik i rënduar, shqiptarët krijojnë vetë korsinë e tretë në autostradë

Shkruar nga: A Shehaj | Publikuar më: 14.09.2026, 13:58



Share



Share



Në pranverën e këtij viti, autostrada Tiranë-Durrës u zgjerua në tre korsi kalimi, si dhe me një korsi të dedikuar për emergjencat, në përputhje me standardet moderne të infrastrukturës rrugore.

Por ky përmirësim nuk shtrihet në të gjithë aksin. Zgjerimi përfundon në zonën e mbikalimit të Rinasit, ndërsa pjesa tjetër e autostradës vijon të paraqitet me të njëjtat problematika, madje në disa segmente situata duket edhe më e rënduar.

Veçanërisht problematik paraqitet segmenti Maminas-Flakë-Sukth, ku gjendja e rrugës, gropat dhe amortizimi i asfaltit, të kombinuara me trafikun e rënduar dhe fluksin e lartë të automjeteve, e bëjnë lëvizjen të vështirë dhe të rrezikshme.

Përballë radhëve të gjata dhe trafikut të dendur, disa drejtues mjetesh kanë zgjedhur të krijojnë vetë një "korsi të tretë", duke lëvizur në krahun e djathtë të automjeteve që ndodhen në dy rreshtat e tjera.

Por kjo manovër përbën një rrezik serioz për sigurinë rrugore. Kalimi në të djathtë mund të sjellë situata të rrezikshme, ndërsa në anë të rrugës ndodhen kanale dhe hapësira të pambrojtura, pa barriera mbrojtëse. Në rast të humbjes së kontrollit, një automjet mund të përfundojë lehtësisht në kanal.

Në këto kushte, segmenti Maminas-Flakë-Sukth mbetet jo vetëm një nga pjesët më të ngarkuara të aksit Tiranë-Durrës, por edhe një pikë me rrezik të shtuar për aksidente.

FACT CHECK: Synimi i JOQ Albania është t'i paraqesë lajmet në mënyrë të saktë dhe të drejtë. Nëse ju shikoni diçka që nuk shkon, jeni të lutur të na e [raportoni këtu](#).

JOQ Sondazh
KLIKO PËR TË VOTUAR

TË NGJASHME



Më të Lexuarat



Albania për
Media
Etive

ARTIKULL JOETIK?

Me të fundit



Dërgo materialin tënd këtu >

Puno me ne!

Marketing

Politika e privatësisë

Rreth Nesh

Kushtet e përdorimit

Kontakt

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.